

VENDIM
Nr. 343, datë 2.5.2019

**PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE TË FONDEVE
BUXHETORE PËR INSTITUCIONET E SISTEMIT TË DREJTËSISË,
PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 11, 13 dhe 18, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numrat për 50 dhe 1 389 punonjës, miratuar në buxhetin e vitit 2019, përkatësisht, për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, rialokohen për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Numri rezervë për punonjës, miratuar në buxhetin e vitit 2019, për institucionet e sistemit të drejtësisë, pakësohet me 119 punonjës, duke e çuar numrin rezervë në 131 punonjës. Numri i përdorur nga rezerva alokohet përkatësisht, për:

a) 54 punonjës për Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke e çuar numrin e përgjithshëm të institucionit në 1 493 punonjës;

b) 65 punonjës për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

3. Fondet e grupit buxhetor “Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”, miratuar në buxhetin e vitit 2019, në grupin buxhetor nr.29, rialokohen në të njëjtat programe, llogari ekonomike buxhetore dhe në të njëjtat vlera, në grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

4. Fondet e programit “Veprimtaria mbikëqyrëse e KLD”, miratuar në buxhetin e vitit 2019, në grupin buxhetor nr. 63, “Institucione të sistemit të drejtësisë”, rialokohen në të njëjtat llogari ekonomike buxhetore dhe në të njëjtat vlera, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

5. Në grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” shtohet fondi prej 82 000 000 (tetëdhjetë e dy milionë) lekësh, përkatësisht, për shpenzime personeli në masën 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekë, për shpenzime operative në masën 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekë dhe për shpenzime kapitale në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

6. Në grupin buxhetor, të riaktivizuar, nr. 35, “Këshilli i Lartë i Prokurorisë”, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” shtohet fondi prej 108 000 000 (njëqind e tetë milionë) lekësh, përkatësisht, për shpenzime personeli në masën 68 000 000 (gjashtëdhjetë e tetë milionë) lekë, për shpenzime operative në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë dhe për shpenzime kapitale në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

7. Fondet financiare, të parashikuara në pikat 5 e 6, të këtij vendimi, në masën 190 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë milionë) lekë, përballohen nga fondi rezervë, miratuar në buxhetin e vitit 2019, për institucionet e reja të sistemit të drejtësisë, duke e çuar këtë fond në masën 210 000 000 (dyqind e dhjetë milionë) lekë.

8. Të drejtat, detyrimet si dhe dokumentacioni administrativ dhe financiar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, i kalojnë dhe administrohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

9. Ngarkohen Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama